



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:039232

Datë: 10.06.2024

Numri i dokumentit: 05799302

2024:041708

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese Mimoza Shabani dhe praktikanten Elmedina Hakiu në cilësi të procesmbajtëses, në çështjen penale kundër të pandehurit B.I me vendbanim në rrugën "...", Objekti banesor "...." në Ferizaj, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar si: PP/II.nr.128/24 e datës 05 Shkurt 2024, duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me nr.../24e datës 07 Qershor 2024, në mes të pandehurit B.I, në njërën anë dhe përfaqësuesit me autorizim të palës së dëmtuar Kompanisë KRU "B." Sh.A në Ferizaj në anën tjetër, në bazë të nenit 357 par. 1 nënpar. 1.3 të KPP-së (Kodi me numër 08/L-032), si dhe nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, më datë 10 Qershor 2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- **APROVOHET**, marrëveshja ndërmjetësimit me nr. .../24e datës 7 Qershor 2024, në mes të pandehurit B.I, në njërën anë dhe përfaqësuesit me autorizim të palës së dëmtuar Kompanisë KRU "B." Sh.A në Ferizaj në anën tjetër, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj.
- **HUDHET**, Aktakuza Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar: PP/II.nr.128/24 e datës 05 shkurt 2024, dhe **PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurit B.I i lindur me datë, nga i ati Sh..., me vendbanim në rrugën "...." objekti banesor "...." , kati i parë në Ferizaj, me numër personal për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-ës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese në çështjen penale kundër të pandehurit B.I me vendbanim në rrugën në Ferizaj, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar: PP/II.nr. 128/24 e datës 02.02.2024, duke vepruar në këtë çështje penale në bazë të nenit 240 par.1 dhe par. 6 të KPP-ës, ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 06 Qershor 2024, në prezencën e prokurorit të shteti, përfaqësuesit të palës së dëmtuar si dhe të pandehurit.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, duke vepruar në këtë çështje penale dhe me pajtimin e palëve në procedurë dhe në bazë të nenit 229 par.1 të KPP-ës dhe nenit 8 par.1 dhe par.2 dhe nenit 14 par.1 dhe par.2 të Ligjit për Ndërmjetësim, vendosi që lënda penale të dërgohet në Qendër për Ndërmjetësim, ndërsa me datën 07 Qershor 2024, nga Qendra e Ndërmjetësimit në Ferizaj është arritur marrëveshja me nr.../24e datës 07 Qershor 2024, në mes palëve në procedurë respektivisht të pandehurit në njërën anë dhe përfaqësuesit me autorizim të palës së dëmtuar Kompanisë KRU “B.” Sh.A në Ferizaj në anën tjetër.

Pala e dëmtuar heqë dorë nga ndjekja penale ndërsa kërkon kompensimi i dëmit nga ana e të pandehurit i precizuar në aktakuzë, me marrëveshjen mes tyre të paguhet në dy këste, ku kësti i parë do të paguhet me datë 07 Qershor 2024 ndërsa kësti dytë do të paguhet me datë 08 Korrik 2024, pra me vullnetin e lirë të tyre janë pajtuar që lëndën ta zgjidhin me marrëveshje për ndërmjetësim.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, pas shikimit dhe vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetësim, vlerëson se palët pa ndonjë kërcënim dhe me vetë dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje penale sipas aktakuzës së evidentuar si: PP/II.nr. 128/24 e datës 05 Shkurt 2024, për veprën penale që e ngarkon të pandehurin të zgjidhet me ndërmjetësim dhe nuk kanë kontestuar asnjë nga pikat e marrëveshjes së ndërmjetësimit, andaj vendosi që ta aprovoj marrëveshjen si të bazuar.

Në bazë të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim, marrëveshja e ndërmjetësimit në datën e aprovimit nga gjykata përkatësisht nga data 10 Qershor 2024 do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Nga sa u tha më lartë, në bazë të nenit 357 par. 1 pika 1.3 të KPP-ës, si dhe nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm Penal,

2024:041708 e datës 10 Qershor 2024

Praktikante,

Elmedina Hakiu

Gjyqtarja,

Mimoza SHABANI

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës, në afat prej 5/pesë/ ditëve, nga dita e parë vijuese pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.